



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:053720  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05630431

**Ac.nr.2470/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.R., nga fshati K., Komuna e Gjilanit, të cilin me autorizim e përfaqëson F.M., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson L.L. nga Gjilani, Zyrtare e Lartë Ligjore në Zyrën e Avokatit të Komunës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1111/2020, të datës 16.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1111/2020, i datës 16.03.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1111/2020, të datës 16.03.2022, ka vendosur si në vijim: “ I. Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditësit S.R. nga fshati K., Komuna e Gjilanit dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit, t’ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 120.84€, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% një page baze, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 16.04.2021, respektivisht për 759 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 1,518.00€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,638.84€, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 10.04.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha

në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270.00 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor e paditura ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, ta anulojë aktgjykimin e atakuar si të pabazuar dhe çështjen ta kthen në rigjykim ose që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohen si i bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 14.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim të shpenzimeve të ushqimit në punë. Në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se paditësi është i punësuar si punëtor teknik në SHFMU “Afërdita”, në fshatin K., Komuna Gjilan, ndërsa i njëjti asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura si punëdhënës për ushqimin ditor gjatë punës siç parashihet në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive Sektoriale. Me parashtresën e datës 15.02.2022, ka bërë ndryshimin e padisë në aspektin objekti, ku në këtë rast ka kërkuar edhe kompensimin e shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, bazuar në pagën bazë të paditësit në shumë prej 241.68 euro, si dhe ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesës për kompensim në emër të ushqimit, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura, që paditësit, t'ia paguajë shumë prej 120.84€, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% një page baze, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 16.04.2021, respektivisht për 759 ditë të pranisë në punë, shumë prej 1,518.00€, respektivisht shumë e përgjithshme prej 1,638.84€, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 10.04.2020, si datë e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar, me arsyet si në përgjigje në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të çështjes në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1111/2020, të datës 16.03.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar pozitën e Punëtorit Teknik në SHFMU “Afërdita”, në fshatin K., Komuna e Gjilanit, të cilin fakt e konfirmon edhe Vërtetimi me nr.prot.100/2019, i datës 12.12.2019, mbi përvojën e punës. Në bazë të Vërtetimit me nr.prot.105/2020, të datës 17.11.2020 të lëshuara nga SHFMU “Afërdita”, në fshatin K., Komuna e Gjilanit, gjykata ka vërtetuar se paditësi për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 11.03.2020, ka qenë i pranishëm në punë për 633 ditë, kurse në bazë të Vërtetimit me nr.prot.11/2022 të datës 08.02.2022 të lëshuar nga SHFMU “Afërdita”, në fshatin K., Komuna e Gjilanit, vërtetohet se paditësi për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datë 16.04.2021, ka qenë i pranishëm në punë për 126 ditë, respektivisht në total 759 ditë, ashtu që konform nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura duhet t’ia kompensoj shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro në ditë, respektivisht shumën në lartësi prej 1,518.00 euro. Po ashtu, në bazë të Listës së pagave të lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi pagën neto e ka 260.15 € dhe ka përvojë pune 11 vite e 28 ditë, fakt ky i vërtetuar përmes Vërtetimit nr.120/20 të dt.08.12.2020, ashtu që konform nenit 35 paragrafi 8 pika 8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit të njëjtit i takon kompensimi i shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë, apo shuma e të hollave në lartësi prej 120.84€. Lidhur me vendosjen mbi kamatën gjykata u bazua në kuptim të nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet konform nenit 452.1 të LPK.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht Punëtor Teknik në SHFMU “Afërdita” në K., Komuna Gjilan, dhe i njëjti ka 11 vite e 28 ditë përvojë pune, i cili fakt vërtetohet edhe në bazë të vërtetimit me numër protokollit 120/2020, të datës 08.12.2020, të lëshuar nga SHFMU “Afërdita” në K., Komuna Gjilan. Ndërsa në bazë të vërtetimit me numër të protokollit 105/2020, të datës 17.11.2020, dhe vërtetimit me numër të protokollit 11/2022, të datës 08.02.2022, të lëshuar nga SHFMU “Afërdita” në K., Komuna Gjilan, është vërtetuar fakti se paditësi për periudhën nga data 18.04.2017, deri me datë 16.04.2021, ka gjithsej 759 ditë prezentë në punë, kurse në bazë të vërtetimit të me numër të protokollit 15/2022, të datës 10.02.2022, është vërtetuar se paditësi pagën bazë e ka në lartësi prej 241.68 euro në muaj.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, përcaktohet se: ”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditësve të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënës i paditëses. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditëses.

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditësit gjen mbështetje në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit datë 18.04.2017, ku është paraparë se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore*”, si dhe në nenin 35 paragrafi 8, pika 8.1 të kësaj Kontrate, ku përcaktohet se “*Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej: për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë*”, ndërsa me pikën 8.5 të po këtij neni parashihet se: “*Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse*”. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, ku në nenin 35 par. 7 ka përcaktuar se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit*

*në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore... ”. Duke pasur parasysh se është vërtetuar së paditësi për periudhën nga data 18.04.2017, deri me datë 16.04.2021, ka gjithsej 759 ditë të pranisë në punë, në këtë rast Gjykata e Apelit, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë që paditësit t’i njihet kompensimi për ushqim në vlerë prej 1,518.00 euro, pasi që gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në përputhje me dispozitën e sipërcituar lidhur me të drejtën e paditëses për kompensimin e ushqimit. Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale sa i përket kërkesës për kompensimin e pagës jubilarë në vlerën e 50% të një page bazë, pasi që është vërtetuar së paditësi ka 11 vite e 28 ditë përvojë pune, ndërsa 10 vite të përvojës së punës i ka arritur në vitin 2020, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë. Andaj, gjykata e shkallës së parë duke i referuar këtyre dispozitave, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur që paditësit për 10 vite të përvojës së punës t’i njihet kompensimi në vlerë prej 50% të një page bazë, në shumë prej 120.84 euro, ku paga bazë mujore e paditësit është 241.68 euro.*

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 2 par.1.2 të kësaj kontrate është paraparë së “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunitat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Ndërsa lidhur me pretendimin se palët nënshkruese të kontratës kolektive nuk kanë bërë asnjë veprim që të sigurojnë mjete buxhetore që ta bëjnë kontratën të zbatueshme, Gjykata e Apelit vlerëson së koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësit dhe detyrimin e të paditurës.

Lidhur me pretendimin së kërkesa e paditësit është vjetërsuar bazuar në nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës, pasi që paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme para se të dorëzohet padia në gjykatë, Gjykata e Apelit, vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditësit t’ia paguaj shpërblimin jubilar dhe kompensimin për ditët e pranisë në punë pa pasur nevojë që paditësi t’i drejtohet me kërkesë, dhe së në rastet kur kemi të bëjmë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuarit, në këtë rast paditësi për realizimin e të drejtës së tij t’i drejtohet gjykatës me padi. Për më tepër, në shkresat e lëndës ekziston kërkesa 10.02.2020, përmes së cilës paditësi ka kërkuar nga e paditura kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë. Gjykata e Apelit vlerëson së kërkesa e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim duke marrë për bazë dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet së “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Kjo për faktin së nga data 18.04.2017, kur ka filluar obligimi i të paditurës për pagesën e kompensimit të ushqimit e deri me datë 14.04.2020, ku paditësja e ka paraqitur padinë në gjykatë nuk kanë kaluar 3 vite. Në këtë rast nuk ka parashkrim as për kërkesën për shpërblim jubilar duke qenë së paditësi të drejtën për të kërkuar shpërblimin jubilar e ka fituar në vitin 2020, kur i ka arritur 10 vite të përvojës së

punës, ndërsa parashtresën për ndryshimin e padisë përmes së cilës e ka kërkuar shpërblimin jubilar e ka paraqitur në gjykatë me datë 15.02.2022.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.2470/2022, datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari  
Hysni Bardheci